



## Periodiku AMF

**Zhvillohet takimi i radhës së grupit të punës, BE - Shqipëri, për tregun e brendshëm dhe konkurrencën.**

Në datën 29 prill 2009, u zhvillua në Bruksel, takimi i radhës i grupit të punës, BE - Shqipëri, për tregun e brendshëm dhe konkurrencën.

*Vijon në faqen 2*

**Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura**  
**Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar – mars 2009**

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve, për periudhën janar – mars 2009, arritën shifrën 1,944,005 mijë lekë përkundëjt 1,473,848 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 31.90% më shumë.

*Vijon në faqen 2*

**Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2009**

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2009, u dominua në masën 98.06% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 1.94% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

*Vijon në faqen 5*

**Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare për periudhën janar - mars 2009**

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, por ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për periudhën janar- mars 2009, shihet një rritje prej 7.34% e kontributeve dhe një rritje prej afër 1% e numrit të kontribuesve, krahasuar me fundvitin 2008.

*Vijon në faqen 6*

**Ngjarje dhe zhvillime të tjera**

**Zhvillohet Konferenca për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEC Forum Conference)**

Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare të Hungarisë në bashkëpunim me IOPS (International Organization on Pension

Supervision) zhvilluan gjatë periudhës 23-25 mars 2009, Budapest, Hungari, Konferencën për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (**CEEC Forum Conference**).

*Vijon në faqen 8*

**Zhvillohet seminari mbi parimet kryesore në sigurime, për mbikëqyrësit nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore dhe Azisë Qendrore e Transkaukazisë**

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI), Zvicër në bashkëpunim me Institutin e Bashkuar të Vjenës (JVI), Austri, zhvilluan gjatë periudhës 20 – 24 prill 2009, seminarin mbi parimet kryesore në sigurime, për mbikëqyrësit nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore dhe Azisë Qendrore e Transkaukazisë, (Selected Insurance Core Principles for Supervisors from Central and Eastern Europe and Central Asia and Transcaucasia).

*Vijon në faqen 9*

**Mbi organizimin e programit të trajnimit mbi zhvillimin e tregut të titujve**

Në datat 20 - 30 Prill 2009, në Washington DC, në ambientet e Institutit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Tregut të Titujve, u organizua një program trajnimi dy javor mbi zhvillimin e tregut të titujve.

*Vijon në faqen 10*

**Zhvillohet trajnimi i avancuar për reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata**

Në datat 20 – 25 prill 2009, në Zagreb, Kroaci, Bicon BA (Insurance Training & Consulting in Stockholm) me asistencë të SIDA-s (Swedish International Development Agency) zhvilluan fazën e dytë të seminarit mbi reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata.

*Vijon në faqen 11*

**Edukimi i konsumatorit**

**Zhvillimi i industrisë së skemave kolektive të investimeve në tregjet në zhvillim 2005 – 2007** [Draft-raport i shkëputur nga Komiteti i Vendeve në Zhvillim, të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO)]

*Vijon në faqen 12*

## Në këtë numër:

Zhvillohet takimi i radhës së grupit të punës, BE - Shqipëri, për tregun e brendshëm dhe konkurrencën. **2**

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura **2**

Ngjarje dhe zhvillime të tjera **8**

Edukimi i konsumatorit **12**

## Zhvillohet takimi i radhës së grupit të punës, BE - Shqipëri, për tregun e brendshëm dhe konkurrencën.



Selia e BE, Bruksel

Në datën **29 prill 2009**, u zhvillua në Bruksel, takimi i radhës i grupit të punës, BE - Shqipëri, për tregun e brendshëm dhe konkurrencën. Gjatë këtij takimi, nga pala shqiptare u paraqit informacion i detajuar për të gjitha pikat e axhendës, duke u fokusuar në angazhimet e marra në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Përkohshme dhe Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit; Dokumentit të Partneritetit Evropian (2007), si dhe rekomandimeve të evidentuara nga Progres Raporti Vjetor i Komisionit për Shqipërinë (2008).

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare paraqiti një raport mbi fushat, të cilat rregullohen dhe mbikëqyren nga ky Institucion: Sigurimet, letrat me vlerë dhe pensionet, duke u fokusuar në aspektin e zhvillimeve legjislative, ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale gjatë vitit 2008.

Rishikimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon sektorët e mbikëqyrur, ka qenë prioritet i punës së AMF-së edhe për vitin 2008. Përjasja me direktivat Evropiane, në kuadër të angazhimeve të institucionit dhe të vendit për

Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim -Asociimit me Bashkimin Evropian, si dhe përshtatja e rregullave me kërkesat dhe nevojat e zhvillimit të shëndoshë të tregjeve, mbeten faktorët kryesorë në ndërmarrjen e nismave ligjore nga ana e AMF.

Në fillim të takimit, Komisioni përgëzoi punën e mirë që është bërë vitet e fundit në drejtim të forcimit të rolit dhe kapaciteteve të AMF si një rregullator i integruar.

Gjatë prezantimit të zhvillimeve të fundit gjatë vitit 2008, nga ana e AMF, theksi u vendos në shkallën e përafrimit të projekteve ligjore, përfshi dhe ato që janë në proces me direktivat e BE, forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale, si faktorë të rëndësishëm të procesit të integritit të vendit dhe angazhimeve të institucionit në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit.

Në përfundim të prezantimit, anëtarët e komisionit drejtuan një sërë pyetjesh, të cilat kryesisht u fokusuan në detaje të veçanta në lidhje me shkallën e legjislacionit të BE të përafuar, si dhe me rritjen e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve të AMF në përgjigje të sfidave që burojnë nga dinamika e zhvillimit të tregjeve të mbikëqyrura dhe procesit të integritit në tërësi.

## Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

## Vështrim mbi tregun e sigurimeve, janar - mars 2009

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve, për periudhën janar - mars 2009, arritën shifrën 1,944,005 mijë lekë përkundrejt 1,473,848 mijë lekë të realizuara në të njëjtën periudhë të vitit 2008 ose 31.90% më shumë.



Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 47.34% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 52.66% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve në veçanti, kemi një rritje në masën 40.79% të sigurimeve të Jetës dhe 31.24% të

sigurimeve të Jo - Jetës.

Megjithë rritjen që shënuan sigurimet e Jetës, sërish 92.64% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo - Jetës.

Gjatë 3 - mujorit të parë të 2009 u nënshkruan rreth 160,976 kontrata sigurimi, ose rreth 24.90% më shumë se në njëjtën periudhë të vitit 2008.


Grafik: Struktura e tregut të sigurimeve, janar - mars 2009



Tabelë: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - mars (2008 - 2009)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
	2008	2009
<i>Periudha janar - mars</i>		
A) Sigurim i Jetës	101,663	143,129
B) Sigurim i Jo - Jetës	1,372,185	1,800,876
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	938,452	1,023,625
b) Sigurimi Vullnetar	433,733	777,251
<b>TOTAL</b>	<b>1,473,848</b>	<b>1,944,005</b>

Grafik: Volumi i primit të shkruar bruto, janar - mars 2009 (Jeta dhe Jo - Jeta)



## Sigurimet e detyrueshme

Gjatë periudhës janar - mars 2009, sigurimet e detyrueshme motorrike vazhduan të dominojnë strukturën e tregut, duke sjellë 52.66% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, në 3 - mujorin e parë 2009, arritën 668,474 mijë lekë, ose 0.97% më pak se në periudhën janar - mars 2008.

Në janar - mars 2009, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 313,305 mijë lekë, ose rreth 37.60% më shumë se në periudhën janar - mars 2008.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë 3 - mujorit të parë të 2009 arritën në 41,874 mijë lekë, apo 17.14% më shumë se në periudhën janar - mars 2008.

## Sigurimet vullnetare

Në periudhën janar - mars 2009, të ardhurat nga

sigurimet vullnetare arritën në 920,380 mijë lekë, ose 71.91% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo - Jetës, me të ardhura 777,251 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 28.94%, të pasuara nga sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 24.91%, sigurimi kasko me 21.21% dhe peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, si dhe sigurimet e garancisë.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - mars 2009, arritën në 87,190 mijë lekë, ose 74.29% më shumë se në periudhën janar - mars 2008. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 69.61% të të ardhurave të këtij grupi.


Primet në sigurimet e Jetës, në 3 - mujorin e parë të vitit 2009, arritën në rreth 143,129 mijë lekë, ose rreth 40.79% më të larta se në po të njëjtën periudhë të vitin 2008. Rritja në sigurimet e Jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredithënies dhe sigurimit të Jetës për efekt kredie.

## Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit


Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo - Jetës ndahet ndërmjet kompanive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Inter Albanian, Albsig, Intersig dhe Eurosig.

Sigal, udhëhoqi tregun me 29.39% të primeve.

Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar - mars 2009 (Jo - Jeta)



Grafik: Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, janar - mars 2009 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal Life, Insig dhe Sicred. Sigal Life udhëhoqi tregun me 49.25% të primeve.

#### Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - mars 2009 kapi vlerën 382,308 mijë lekë, ose 23.57% më shumë se në janar - mars të vitit 2008. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimeve motorrike me 350,960 mijë lekë, apo 91.80% të totalit. Në portofolin “Kartoni Jeshil” kemi një rritje të dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimit me 81.83% dhe rritje të numrit të dëmeve të paguara me 62.79%, krahasuar me periudhën janar - mars të vitit 2008.

#### Risigurime

Gjatë periudhës janar - mars 2009, shoqëritë e sigurimit kanë lidhur kontrata me vlerë mbi 11,403 mijë lekë, të cilat i përkasin sigurimit “Aksidente Personale” dhe “Kasko”.

## Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar - mars 2009

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, gjatë 3 - mujorit të parë të vitit 2009, u dominua në masën 98.06% nga transaksionet në instrumenta afatshkurtër (bono thesari) dhe 1.94% nga instrumenta afatgjatë (obligacione).

Nisur nga pjesëmarrja (numër transaksioni) sipas llojit të investitorëve, individë apo persona juridikë, shihet se në peshë specifike më të lartë janë investitorët individualë me 98.20% të totalit të transaksioneve në këtë treg.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë janar - mars, 2008 - 2009

<i>Lloji i Transaksionit</i>	<i>Vlera nominale (në mln lekë)</i>		<i>Ndryshimi (në %)</i>
	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>'09/'08-1</i>
<i>Periudha janar - mars</i>			
<i>Letra me vlerë të Qeverisë</i>			
<i>A Blerje në tregun primar</i>	2,731.77	2,700.18	(1.16)
<i>Individë</i>	2,081.76	1,850.48	(11.11)
<i>Persona juridikë</i>	650.01	849.70	30.72
<i>B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</i>	3,064.32	2,516.83	(17.87)
<i>Individë</i>	2,733.15	2,379.21	(12.95)
<i>Persona juridikë</i>	331.17	137.63	(58.44)
<i>C Blerje nga individët para afatit të maturimit</i>	103.07	196.26	90.41
<i>Individë</i>	100.45	194.36	93.50
<i>Persona juridikë</i>	2.63	1.89	(27.85)
<i>D Vendosje e bonos si kolateral</i>	20.37	24.02	17.95
<i>Individë</i>	20.37	21.01	3.14
<i>Persona juridikë</i>	-	3.02	-
<i>E Shlyerje e vlerës nominale në maturim</i>	1,648.75	1,887.26	14.47
<i>Individë</i>	1,538.30	1,628.17	5.84
<i>Persona juridikë</i>	110.44	259.09	134.59

### Dy grupet e transaksioneve B dhe C


Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** gjatë 3 - mujorit të parë të vitit 2009 ka pësuar një ulje prej 547 milionë lekë ose në masën 17.87%, krahasuar me periudhën janar - mars 2008, shoqëruar dhe me një rënie të numrit të transaksioneve në masën 18.23%.

Transaksioni i llojit **C “Blerje nga individët para afatit të maturimit”** gjatë 3 - mujorit të parë të vitit 2009, ka pësuar një rritje prej 14 milionë lekë ose 90.41%, krahasuar me periudhën janar -

mars 2008, ndjekur nga një rritje në masën 26% të numrit të transaksioneve.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, vihet re një rënie në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C, me rreth 454 milion lekë.

Letra me Vlerë të Qeverisë Janar - Mars 2009



- A - Blerje në tregun primar
- B - Shitje nga portofoli I bankës
- C - Blerje nga individët para afatit të maturimit
- D - Vendosje e bonos si kolateral
- E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

## Zhvillimet e tregut të pensioneve private vullnetare për periudhën janar - mars 2009

Tregu i pensioneve vullnetare mbetet ende një treg i vogël, porë ky si nga këndvështrimi i kontributeve dhe nga numri i kontribuesve. Në këtë treg, për periudhën janar - mars 2009, shihet


një rritje prej 7.34% e kontributeve dhe një rritje prej afër 1% e numrit të kontribuesve, krahasuar me fundvitin 2008.

Në tregun e pensioneve private vazhdojnë të zhvillojnë aktivitetin 3 shoqëri pensionesh: IAPPSH, Capital dhe Sigma IPP.


Tregu i Pensioneve Private Vullnetare 2008, Janar - Mars 2009 (kontribute)

Shoqëria	Numri kontribuesve		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2008	3mI 2009	'09/'08-1	2008	2009
<i>Periudha</i>					
<i>IAPPSH</i>	1,641	1,667	1.58	42.50	42.70
<i>Capital</i>	1,542	1,559	1.10	39.94	39.93
<i>Sigma IPP</i>	678	678	-	17.56	17.37
<i>Total</i>	3,861	3,904	1.11	100.00	100.00

Struktura e Tregut të Pensioneve Private (sipas kontributeve)



Struktura e Tregut të Pensioneve Private (sipas numrit të kontribuesve)



## Ngjarje dhe zhvillime të tjera

### Zhvillohet Konferenca për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEC Forum Conference)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Hungarisë në bashkëpunim me IOPS (International Organization on Pension Supervision) zhvilluan gjatë periudhës 23 - 25 mars 2009, Budapest, Hungari, Konferencën për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (CEEC Forum Conference).

Dita e parë e konferencës ju rezervua takimit të të gjitha vendeve anëtare të IOPS, pjesë e së cilës është edhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje me rëndësi në kuadër të përmirësimit të mbikëqyrjes së fondeve private të pensioneve, ku një rëndësi e veçantë i'u dha metodologjisë për rishikimin e

sistemit mbikëqyrës duke përdorur principet e IOPS, si dhe fokusit mbi edukimin financiar, prezantuar nga Z. Flore-Anne Messy, (Administratore e Departamentit të Çështjeve Financiare, pranë OECD). Gjithashtu, gjatë takimit u bënë edhe ndryshime në dokumentet ekzistues, si ato mbi menaxhimin e mbikëqyrjes, disiplinimin e tregut, marrjen e informacionit, etj.

Konferenca nisi punimet e saj më datë 24 mars 2009, e cila përfaqësoi një platformë për industrinë e fondeve të pensioneve për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Në të pati përfaqësues nga institucionet e pensioneve private, të cilët menaxhojnë, si skemat vullnetare, ashtu dhe ato të detyrueshme.

Kjo konferencë pati një rëndësi të veçantë për vendet e CEE, të cilat gjatë dekadës së fundit kanë filluar zbatimin e sistemit shumë kolonësh të pensioneve. Konferenca e mbajtur u nda në 4 sesione dhe temat kryesore të diskutimit ishin:

- o Faza e pagesës së pensionit nga llogaritë individuale në skemat e detyrueshme me kontribute të përcaktuara (DC).



- o Kriza financiare në sistemet private të pensioneve.
- o Kufizimet në investime.
- o Mbikëqyrja e shoqërive administruese të skemave të detyrueshme të pensioneve.

Rëndësia e konferencës qëndron në mundësinë e diskutimit dhe marrjes së eksperiencës për ngritjen e një mbikëqyrje sa më efektive ndaj fondeve të pensioneve të detyrueshme dhe private, si dhe orientimit të politikave investuese në kudër të krizës financiare.

## Zhvillohet seminari mbi parimet kryesore në sigurime, për mbikëqyrësit nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore dhe Azisë Qendrore e Transkaukasisë

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI), Zvicër në bashkëpunim me Institutin e Bashkuar të Vjenës (IVI), Austri, zhvilluan gjatë periudhës 20 - 24 prill 2009, seminarin mbi parimet kryesore në sigurime, për mbikëqyrësit nga vendet e Evropës Qendrore e Lindore dhe Azisë Qendrore e Transkaukasisë, (Selected Insurance Core Principles for Supervisors from Central and Eastern Europe and Central Asia and Transcaucasia).

Qëllimi i seminarit ishte *përmirësimi i aftësive të mbikëqyrësve në sigurime, të vendeve të këtij rajoni.*



FSI Regional Seminar on SELECTED INSURANCE CORE PRINCIPLES  
20-24 April 2009

Përmbajtja e materialeve të trajtuara nga lektorët në seminar, të renditura më poshtë, ishte fokusuar tek parimet bazë të sigurimeve, të miratuara nga Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS):

- Trajtimi shkurtimisht i parimeve bazë të Sigurimit, IAIS, zbatimi dhe vlerësimi i tyre.
- Sistemi i mbikëqyrjes së sigurimeve, ai i bazuar në rregulla, ai tradicional (rule based) dhe ai i bazuar në risk (risk based), duke u përqëndruar më shumë tek komponentët kryesorë të drejtimit të bazuar në risqet e biznesit të sigurimeve.
- Përcaktimi i mjaftueshmërisë së kapitalit dhe vlerësimit të riskut.
- Parandalimi i pastrimit të parave dhe përballja me financimin e terrorizmit dhe mashtrimeve në sigurime.
- Provigjonet teknike dhe investimet korresponduese, politika e investimeve, menaxhimi i aseteve dhe aftësia paguese e sigurveuesit.
- Monitorimi off-site dhe inspektimi on-site, si dhe përdorimi i drejtimit të bazuar në risk.
- Menaxhimi i shoqërisë (corporate governance) dhe disiplina e tregut. Standardet ndërkombëtare dhe raste praktike. Parandalimi, ndërhyrja, sanksionet dhe nxjerrja nga tregu. Identifikimi i hershëm i sinjaleve paralajmëruese, mjetet mbikëqyrëse, kur dhe si t'i përdorin mbikëqyrësit ato.

· Roli i menaxhimit të riskut, kriza financiare dhe mësimet që dalin prej saj.

Seminari organizoi ndarjen në grupe pune për diskutimin dhe analizën e rasteve të studimit të trajtuara në seminar, lidhur me shembuj të një llogaritje të mjaftueshmërisë së kapitalit bazuar në metodën e riskut të biznesit të sigurimeve, zbatimin e kriterëve të licencimit të një shoqërie sigurimi, procesin e aprovimit të saj dhe në vazhdimësi, parandalimin e pastrimit të parave në fushën e sigurimeve, veçanërisht në atë të jetës, si dhe vlerësimin dhe menaxhimin e riskut.

U përmend rasti i një kompanie me probleme, e cila nxiti diskutimet dhe u ofruan raste interesante shembujsh nga vendet e ndryshme e zgjidhje, bazuar në legjislacionin e çdo vendi. Debati ishte shumë i frytshëm dhe edukues me punën në grup.

Lektorët e seminarit ishin specialistë me përvojë të gjatë në fushën e sigurimeve, kryespecialistë në sektorin financiar të FSI, administratorë kryesorë në IAIS, Zvicër, specialistë në mbikëqyrjen e integruar të sigurimeve të Autoritetit Mbikëqyrës Zvicerian, të cilët ofruan njohuri në fushën e parimeve bazë në sigurime dhe shembuj nga përvoja e tyre e gjerë e praktike në këtë fushë.

## Mbi organizimin e programit të trajnimit mbi zhvillimin e tregut të titujve

Në datat 20 - 30 Prill 2009, në Washington DC, në ambientet e Institutit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Tregut të Titujve, u organizua një program trajnimit dy javor mbi zhvillimin e tregut të titujve.



Gjatë programit mbi zhvillimin e tregut të titujve, Washington DC

Ky program ishte projektuar si një forum për shkëmbimin e praktikave më të mira, për zhvillimin dhe rregullimin e tregut të letrave me vlerë, të prezantuara këto nëpërmjet leksioneve, tavolinave të rrumbullakta dhe studimit të rasteve të ndryshme.

Në këtë program trajnimit, ndanë eksperiencat e tyre, ekspertë të ndryshëm të Komisionit të Titujve dhe Bursave, Amerikë, përfaqësues të agjencive qeveritare, akademikë, si dhe përfaqësues nga industria e tregut të letrave me vlerë në Shtetet e Bashkuara.

Përfaqësues të vendeve me tregje në zhvillim, ndanë eksperiencat e tyre dhe diskutuan për parimet bazë të tregut të titujve, fokusuar në zgjidhjen e krizave dhe abuzimeve të tregut, duke theksuar gjithashtu praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Në javën e parë të programit, u diskutuan tema të ndryshme si: *Qeverisja e shoqërive, kriza e fundit financiare, kuadri rregullator Amerikan, problemet në lidhje me standardet e mbikëqyrjes dhe zbatueshmërisë, teknikat e mbikëqyrjes së tregut të titujve, mbikëqyrja e brokerave dhe këshilltarëve në investime, bashkëpunimi i mbikëqyrjes ndërkombëtare, problemet e kontabilitetit në tregjet në zhvillim, inspektimi i bursave dhe zhvillimet e*

*fundit në lidhje me tregtimin në bursë. Gjithashtu, gjatë kësaj jave u bë studimi në grup i rasteve, të cilat kanë lidhje me inspektimin dhe mbikëqyrjen e këshilltarëve në investime.*

*Java e dytë u fokusua në çështje si: Sfidat që ju paraqiten rregullatorëve të tregut të titujve, mashtrimi në internet, investigimi i manipulimit të tregut, teknikat dhe procedurat e intervistimit dhe dhënies të dëshmive, tregtimi i brendshëm, zbatueshmëria në lidhje me fondet e investimeve dhe brokerat, mashtrimi i raportimit financiar, tregjet në zhvillim dhe tendencat globale në lidhje me mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të titujve, bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të zbatueshmërisë dhe edukimi i investitorëve. Studimi në grup i kësaj jave ju kushtua pikërisht çështjeve dhe problemeve në lidhje me zbatueshmërinë.*

Studiues dhe ekspertë të ndryshëm të Komisionit të Titujve dhe Bursave, Amerikë, në prezantimet e bëra, ndanë eksperiencën e tyre në lidhje me tregun e titujve.

Në këtë program, morën pjesë përfaqësues nga më shumë se 65 vende të ndryshme të botës dhe u mbyll me fjalimin e Kryetares së Komisionit të Titujve dhe Bursave (U.S. Securities and Exchange Commission), Zj. Mary L. Schapiro, e cila gjithashtu shpërndau në fund të programit certifikata të pjesëmarrjes për të gjithë të pranishmit.

## Zhvillohet trajnimi i avancuar për reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata

Në datat 20 - 25 prill 2009, në Zagreb, Kroaci, Bicon BA (Insurance Training & Consulting in

Stockholm) me asistencë të SIDA-s (Swedish International Development Agency) zhvilluan fazën e dytë të seminarit mbi reformën në sistemin e pensioneve dhe krijimin e zgjidhjeve afatgjata.

Zhvillimi i seminarit, kishte si qëllim, prezantimin e projekteve të hartuara nga çdo grup pune sipas shteteve pjesëmarrëse në trajnim. Me shumë interes ishte prezantimi, mbajtur nga z. Mladen Latkovic, menaxher risku në shoqërinë “Raiffeisen Pension Fund”, i cili analizoi sistemin kroat të pensioneve private, duke u përqëndruar kryesisht në tema si: Menaxhimi i riskut, mbikëqyrja, menaxhimi i aseteve nga kompania menaxhuese, tarifat e shoqërisë, etj., si dhe prezantimet e pedagogëve suedez, të cilët ofruan një përmbledhje të sistemit të studiuar gjatë fazës së parë në Suedi.

Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e seminarit ishte dhe krijimi i grupeve midis pjesëmarrësve për të diskutuar rreth çështjeve të ndryshme me zbatim në sistemin e pensioneve. *Një çështje me shumë interes ishte ajo e krizës financiare dhe ndikimi i saj në sistemin shumë kolonësh të pensioneve.* Grupi Shqiptar prezantoi temën: “Analiza dhe prognoza e shtyllës së parë të pensioneve”.

Në fjalën mbyllëse u nënvizua frytshmëria dhe efektiviteti i kësaj jave si në analizën e sistemit suedez dhe atij kroat, ashtu edhe në marrjen e një praktike të vlefshme për vende si Shqipëria, të cilat po mundohen të reformojnë sistemin ekzistues të pensioneve në kuadër të zbatimit të një sistemi modern, i cili duhet të jetë financiarisht i qëndrueshëm dhe shoqërisht i pranueshëm.

Në fund të këtij trajnimi u shpërndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit.

## Edukimi i konsumatorit

# Zhvillimi i industrisë së skemave kolektive të investimeve në tregjet në zhvillim 2005 – 2007

*[Draft-raport i shkëputur nga Komiteti i Vendeve në Zhvillim, të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO)]*

Ky raport është akoma draft dhe paraqet rezultatet e një studimi të një shkalle të gjerë mbi skemat kolektive të investimeve (CIS – Collective Investments Schemes) dhe kuadrin rregullativ të aplikuar për to në vendet në zhvillim, gjatë viteve 2005 - 2007. Pyetësi u përgatit për Grupin e Punës 5, nga Autoriteti Rregullator i Letrave me Vlerë të Kinës (CSRC). Ndërsa ky raport u përgatit nga Autoriteti i Letrave me Vlerë të Izraelit.

Pyetësi mori formën e një anketimi të titulluar “Studim mbi Zhvillimin e Industrisë së Skemave Kolektive të Investimeve (SKI) në vendet në zhvillim” i cili i është dërguar të gjithë anëtarëve të Komitetit të Vendeve në Zhvillim të IOSCO-s. Duke u mbështetur në konkluzionet e dala nga raportimet e mëparshme, ky pyetësor kishte një fokusim të veçantë në profilizimin e industrisë tregtare të SKI-ve në çdo juridiksion. Kështu, përveç pyetjeve mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen e industrisë, pyetësi i kërkoi institucioneve pjesëmarrëse në të, të jepnin në përgjithësi një informacion të detajuar mbi tregun në përgjithësi dhe gjithashtu mbi strukturën dhe karakteristikat e SKI-ve. Autoritetet rregullatore, të cilët u përgjigjën këtij pyetësi, ishin nga juridiksionet e mëposhtme:

Argjentinë, Barbados, Brazil, Bullgari, Kinë, Taipei Kinez, Kolumbi, Hungari, Indi, Izrael, Jordani, Kore, Lituani, Malajzi, Pakistan, Poloni, Rumani, Slloveni, Afrika e Jugut, Sri Lanka, Tailandë,

Kroaci, Marok, Tunizi, Republika Çeke, Nigeri, Turqi, RMJ e Maqedonisë, Omani dhe Vietnami. Këto 30 juridiksione përbëjnë 37.50% të anëtarëve të Komitetit të Vendeve në Zhvillim dhe totali i tyre i PBB përbën rreth 73.63% të totalit të PBB-së së anëtarëve të këtij komiteti. Siç paraqesin dhe shifrat, në rezultate përfaqësohen shumica e tregjeve më të mëdha dhe më të zhvilluara të skemave kolektive të investimeve anëtare në Komitetin e Vendeve në Zhvillim.

### Konkluzione kryesore

Objektivi i pyetësorit është të sigurojë një anketim të një shkalle të gjerë mbi gjendjen e industrive të Skemave Kolektive të Investimeve (SKI) në vendet në zhvillim dhe të kuadrin rregullativ, sipas të cilit ato funksionojnë. Studimi ka rezultuar i suksesshëm në dhënien e një pasqyre të përgjithshme të aktivitetit të SKI-ve në tregjet në zhvillim.

Konkluzionet kryesore të rezultuara nga ky pyetësor mund të grupohen në dy grupe: (i) të dhëna mbi funksionimin e tregjeve SKI dhe (ii) të dhëna rreth kuadrin rregullativ në zbatim për SKI-të.

#### (I) Aktiviteti i tregut të SKI

**Në tregjet në zhvillim ka një industri të madhe aktive të SKI-ve.** Në tregjet të cilat i janë përgjigjur pyetësorit, në fund të 2007 kishte një total të SKI-ve aktive prej 20,543. Këto skema mbanin asete me një vlerë totale prej mbi US\$ 1.9 trilion.

**Aktiviteti i SKI-ve u rrit fuqishëm gjatë periudhës së anketimit.** Vlera e AUM (assets under management – asete në manaxhim) u rrit gjatë periudhës së anketimit në 28 nga 30 juridiksionet e anketuara. Numri total i fondeve të SKI-ve u rrit me 28.6%, ndërsa vlera totale e AUM u rrit me 105.9%.

**Përmasat e tregjeve të marra në anketim ndërmjet juridiksioneve të ndryshme të vendeve me tregje në zhvillim ndryshonin në një shkallë të lartë.** Numri i

SKI-ve për treg varionte nga 3 deri në 8,907. AUM të mbajtura nga SKI-të në çdo juridiksion varionte nga 2.2 milion US\$ deri më 612 miliardë US\$.

**Aktiviteti i tregut në tre tregje ndikoi në mënyrë thelbësore në statistikën e përgjithshme.** Brazili, Kina dhe Koreja, së bashku përbënin 1,375 miliardë US\$ nga totali prej 1,911 miliardë US\$ të vlerës së AUM në 2007. Përveç kësaj, 81% e rritjes së AUM, gjatë periudhës së anketimit, kishte origjinën në këto tre tregje. Duke u mbështetur në shifrat e fondeve të SKI, vetëm Brazili dhe Koreja përbëjnë 58% e të gjithë SKI-ve në të tridhjetë juridiksionet të mbuluara nga ky anketim.

**Fondet e hapura (open - ended funds) janë kryesisht shumë më të përhapura se sa fondet e mbyllura (closed - ended funds).** Afërsisht 80% e SKI-ve ishin të hapura. Fondet e hapura përbëjnë 90% të të gjithë AUM. Ndërsa fondet e hapura gjenden në të gjitha juridiksionet, asnjë fond i mbyllur nuk ekziston në mbi 1/4 e tyre.

**Numri total i kompanive aktive të menaxhimit të aseteve të SKI në juridiksionet që iu përgjigjën anketimit, u rrit nga 768 në 1,025, një rritje prej 33%.** Numri mesatar i kompanive të menaxhimit të aseteve për juridiksion ishte 34. Gjashtëmbëdhjetë nga tridhjetë autoritetet, të cilët iu përgjigjën pyetësorit, kanë në tregjet e tyre ndërmjet 20 dhe 40 kompani aktive të menaxhimit të aseteve.

**Kompanitë e huaja të menaxhimit të aseteve kanë prirjen të kenë një prezencë influencuese në ato juridiksione ku ato janë aktive.** Në ato tregje ku kanë hyrë kompanitë e huaja të menaxhimit, vërehet se ato kanë prirjen të kenë një prezencë thelbësore dhe të cilat përbënin mesatarisht një të tretën e të gjithë kompanive të menaxhimit të aseteve në ato juridiksione. 16 nga 30 juridiksionet, kanë kompani të huaja të menaxhimit të aseteve, të cilat janë aktive në tregjet e tyre.

**Rreth një e treta e kompanive të menaxhimit të aseteve ishte në pronësi të bankave.** Në përgjithësi, gjatë periudhës së studimit, kishte një prirje të ulët por të qëndrueshme të kompanive të menaxhimit të aseteve për të mos qenë në pronësi të bankave, gjithsesi pati shtatë juridiksione në të cilat u rrit numri i kompanive të menaxhimit të aseteve nën pronësinë e bankave.

**Relativisht një grup i vogël i kompanive më të mëdha të menaxhimit të aseteve në çdo juridiksion dominojnë akoma në tregjet e tyre.** Mesatarisht pesë kompanitë më të mëdha të menaxhimit në çdo juridiksion zotëronin 64% të tregjeve të tyre në 2007. Ndërsa 10 kompanitë më të mëdha të menaxhimit zotëronin mesatarisht 83% të tregut. Ky përqëndrim i tregut ka pësuar një rënie të lehtë gjatë periudhës së studimit, respektivisht nga 68% dhe 86%.

**SKI-të, strategjia e investimeve, e të cilave u fokusua në kapitale, ishin më të suksesshmet gjatë periudhës së anketimit. AUM-et në fondet e kapitaleve u rritën me më shumë se 300% gjatë periudhës së anketimit.** Numri i fondeve të kapitaleve u rrit me 48%. Duke bërë një krahasim, AUM-et në SKI-të, të investuara kryesisht në produkte me të ardhura fikse, u rritën me vetëm 39% dhe numri i fondeve të tilla u rrit me 6%. Në fazat fillestare të studimit fondet me të ardhura fikse ishin më shumë të përhapura me më shumë se dyfishi i AUM-eve të fondeve të kapitaleve dhe ky ndryshim pozicionimi reflekton rritjen e fortë të tregjeve të kapitaleve ndërmjet 2005 dhe 2007.

**Një numër i konsiderueshëm i kanaleve të shpërndarjes të kuotave të SKI janë shfrytëzuar në tregjet në zhvillim.** Bankat (26 juridiksione) dhe kompanitë e letrave me vlerë (21 juridiksione) janë më të zakonshmet, por kompanitë e sigurimeve, kompanitë e huaja të menaxhimit të SKI-ve dhe këshilluesit e pavarur financiarë, janë secili të lejuar në më shumë se një e treta e juridiksioneve.

**Pjesa më e madhe e juridiksioneve, të cilat iu**

**përgjigjën anketimit, rregullojnë ose ndalojnë pagesën e tarifave lidhur me SKI-të.** Aty ku autoritetet vendosin kufizime të tilla, ato tentojnë që t'i zbatojnë këto kufizime në të gjithë spektrin e kategorive të tarifave që lidhen me aktivitetin e SKI-ve.

## **(ii) Kuardi rregullativ për SKI-të**

**Kuadri rregullativ për SKI-të në tregjet në zhvillim mbulon një fushë të gjerë çështjesh.** Në pothuajse të gjitha juridiksionet, kuadri rregullativ në zbatim trajton investimet nga SKI-të, çmimet e kuotave, vlerësimin e asetëve, dhënien e informacionit tek publiku dhe kujdestarit. E vetmja çështje, e cila duket në përgjithësi si më pak e rregulluar, është shpërndarja, por edhe për të, 23 nga juridiksionet e anketuara, vendosin rregulla. Numri i viteve, që në momentin në të cilin është prezantuar për herë të parë kuadri rregullativ mbi SKI-të, varion nga 18 muaj deri në 47 vjet, me një mesatare prej 17 vitesh.

**Shumë të përhapura janë rregullat mbi atë se kush mund të ketë në pronësi një kompani menaxhuese të SKI.** 24 nga juridiksionet kërkojnë në minimum kriteresh ose kufizime të tjera. Forma më e përhapur që kjo merr, është një minimum kapitali i kërkuar për t'u paguar, i cili aplikohet në 19 juridiksione dhe i cili në shumicën e rasteve është nën 1 milion US\$. Kërkesat e tjera të lidhura me natyrën e aksionerit (p.sh. nëse është një institucion financiar dhe kufizimet e “fit and proper”) aplikohen në 14 juridiksione.

**Kompanitë e menaxhimit të fondeve duhet, në shumicën e juridiksioneve, të jenë korporata.** 26 nga 30 juridiksione kërkojnë që kompanitë e menaxhimit të fondeve të jenë të inkuorporuara.

**Gjithashtu, në pjesën më të madhe të juridiksioneve të anketuara, ekzistojnë rregulla mbi stafin e kompanive të menaxhimit të fondeve.** 24 juridiksione kërkojnë që personeli të licencohet. Vetëm më pak se gjysma e juridiksioneve kërkojnë një numër minimal të stafit në një kompani

menaxhimi fondesh, dhe në shumicën e këtyre rasteve deri në 5 anëtarë stafi janë të kërkuar.

**Stafi drejtues në kompanitë e menaxhimit të fondeve, shpesh kërkohet të kenë një nivel minimal eksperience.** 17 juridiksione vendosim të tilla kërkesa. 10 nga këto kërkojnë ndërmjet një dhe tre viteve eksperiencë. Eksperienca mesatare e kërkuar është 3.4 vite.

**Rregulla të cilat ndalojnë kompanitë e menaxhimit të fondeve për të ofruar shërbime të tjera financiare janë shumë të përhapura.** Në gjysmën prej juridiksioneve, kompanitë e menaxhimit të fondeve janë gjithashtu të ndaluara të ofrojnë këshillime mbi investimet. Të gjitha këto jursidiksione, përveç në dy prej tyre, ndalohet menaxhimi i portofoleve të investimeve të palëve të treta.

**Kompanitë e menaxhimit të fondeve janë gjerësisht të lejuara të delegojnë menaxhimin e portofoleve dhe funksionet logjistike tek palët e treta.** Delegimi i vendim-marrjes mbi investimet është i lejuar në 20 juridiksione dhe kryerja e transaksioneve mund të delegohet në 23.

**Kompanitë e menaxhimit në tregjet në zhvillim janë në përgjithësi të lejuara të investojnë në SKI të tjera, të cilat ato i menaxhojnë.** Vetëm 5 juridiksione i ndalojnë investime të tilla.

**Mbikëqyrja e fondeve individuale është shumë e përhapur.** Kërkesa për miratim nga rregullatori për çdo SKI të re është pothuajse e zbatueshme nga të gjitha juridiksionet pjesëmarrëse.

**Kërkesa për një numër minimal investitorësh në ofertat fillestare për një SKI të re është shumë e përhapur.** Kërkesat variojnë nga 1 deri në 200 investitorë, gjithsesi ka një ndarje të qartë të përjasjeve në më tepër se 30 juridiksione, të cilat vendosin këtë rregull duke kërkuar ose më pak se 10 ose mbi 100 investitorë fillestarë.

**Më shumë se gjysma e juridiksioneve kërkojnë që**

**oferta fillestare e kuotave të SKI-ve të ketë një vlerë minimale.** Kjo varion ndërmjet 2,000 US\$ dhe 29 milion US\$, ndërkohë që gjysma e këtyre juridiksioneve kërkonin një vlerë minimale deri në 1 milion US\$.

**Dhënia e informacionit periodik mbi pasqyrat financiare përbën një standard në tregjet në zhvillim.** 26 juridiksione kërkojnë dhënie të tilla informacioni të paktën një herë në vit. 20 juridiksione kërkojnë të paktën dy raportime në vit.

**Materialet promovionale mbi SKI-të, janë të mbikëqyrura në shumicën e juridiksioneve në tregjet në zhvillim.** 19 tregje kërkojnë miratim të plotë dhe në 8 të tjera materiali promovional duhet të paraqitet tek rregullatori lokal. Parashikimet për performancën në të ardhmen, të një fondi, janë të ndaluara në 16 nga 30 juridiksionet.

**Tregjet në zhvillim janë në përgjithësi liberale në përjasjen e tyre për një lëvizje ndër kufitare të parasë për qëllime investimi.** 28 nga pjesëmarrësit lejojnë investimet e huaja në tregun e tyre të kapitalit. Ndër to, vetëm dy vendosin një tavan maksimal për investime nga investitorët e huaj. 25 juridiksione lejojnë që kapitali vendas të mund të investohet jashtë. Në lidhje me këtë dalje investimesh, 7 juridiksione vendosin limite. Këto marrin formën e shumave maksimale të parasë ose janë të shprehura në terma të përqindjes maksimale të investimit të huaj, të cilin ato mund të mbajnë.

**Në 1/4 e juridiksioneve aplikohen marrja e lejeve për shkëmbimin e valutës.** 8 nga këto juridiksione kërkojnë që këmbimi i valutës, nga ose në valutën vendase, të marrë një aprovim zyrtar. Kërkesa të tilla janë më pak të përdorshme në lidhje me investimet që dalin jashtë vendit.

**Kompanitë e huaja të menaxhimit të aseteve mund të hapin degë ose zyra përfaqësimi në rreth gjysmën e juridiksioneve.** Ndërsa shumica e këtyre juridiksioneve (10) lejojnë të dyja format e

aktivitetit të huaj, një sasi e vogël lejon vetëm degë ose zyra përfaqësimi.

**Kompanitë e huaja të menaxhimit të aseteve mund të krijojnë filiale të inkuorporuara në shumicën e juridiksioneve që morën pjesë në anketim.** 25 e juridiksioneve lejojnë kompanitë e huaja të menaxhimit të aseteve të krijojnë një filial lokal ose të zotërojnë pronësi influencuese të filialeve të tilla të menaxhimit të aseteve. Vetëm 5 nga këto juridiksione vendosin një kufi mbi maksimumin që mund të zotërojnë kompanitë e huaja të menaxhimit të aseteve, tre nga këto vendosin limite në 49% dhe dy të tjerat në 70%.

Tabela e mëposhtme paraqet tre kategori informacioni të lidhura me kapitalizimin e tregut për çdo juridiksion që mori pjesë në anketim: (i) vlera stok e kapitalizimit të tregut; (ii) raporti ndërmjet niveleve të kapitalizimit të tregut dhe AUM në SKI-të; dhe (iii) raporti i përbërë i rritjes vjetore të vlerës së kapitalizimit të tregut gjatë periudhës së anketimit. Juridiksionet janë të listuara sipas masës së kapitalizimit të tregut.

	Kap. i tregut 2007 (US\$ B)	AUM/Kap. tregut 2007 (%)	Kap. tregut CAGR 2005-7 (%)
Kina	4,478.55	10.02	233.8
Brazili	1,387.21	44.19	67.6
Korea	1,051.80	29.85	20.4
Afrika Jugut	830.49	11.47	21.1
India	782.82	9.56	43.9
Taipei Kinez	767.08	8.06	17.5
Polonia	527.20	11.70	59.4
Malajzia	325.30	16.29	34.2
Turqia	289.90	8.19	33.4
Izraeli	235.20	15.73	38.5
Tailanda	192.02	24.80	23.1
Hungaria	118.26	15.36	24.0
Nigeria	114.31	0.38	125.5
Kolumbia	102.00	6.86	42.1
Rep. Çeke	90.68	9.46	27.7
Maroku	75.41	22.53	52.4
Pakistani	66.55	7.75	38.7
Jordania	41.20	0.10	4.7
Rumania	35.33	1.39	39.4
Vietnami	32.00	0.94	630.3
Omani	26.68	0.61	32.2
Sllovenia	25.67	20.12	41.9
Bullgaria	21.78	0.68	106.9
Lituania	10.10	5.35	10.8
Barbados	9.40	3.28	-9.2
RMJ e Maqedonisë	7.70	0.03	134.5
Sri Lanka	7.29	0.86	18.5
Tunizia	5.32	46.32	30.4
Argjentina	0.06	11,466.67	9.5

***Për këtë numër punuan:***

E. Shehi, R. Guri, M. Marku, E. Sherri  
L. Lloji, P. Berberi, R. Eltari, E. Zalta,  
E. Kokona

